



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
http://www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Ali Topalli

Nr. Prot. 1514
Datë 26.10.2020

Në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues nr. prot. 1513 të datës 26.10.2020, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”, shpall:

KONKURS

Për ndarjen e bursave universitare për studentët e studimeve themelore (bachelor) dhe studimet postdiplomike (master) të Universitetit të Mitrovicës, për vitin akademik 2020/2021.

I. Bursa universitare iu ndahet studentëve të studimeve bachelor dhe studimeve postdiplomike master.

Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët, të cilët i plotësojnë këto kushte:

1. të jenë student të rregullt të Universitetit të Mitrovicës,
2. të jenë student të vitit të dytë e më lart,
3. të mos kenë vit të përsëritur të studimeve,
4. të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve në afatin e shtatorit,
5. të kenë notë mesatare të studimeve më së paku:

- 8.0 (tetë pikë zero) – për studentët e studimeve bachelor në Fakultetin e Gjeoshkencave, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike; dhe
- 9.00 (nëntë pikë zero) – për studentët e Fakultetit Juridik, Ekonomik dhe të Edukimit.
- 9.00 (nëntë pikë zero) – për studentët e nivelit master.

II. Studentët që i plotësojnë kushtet nga pika I e këtij vendimi duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Dëshminë e aplikimit për bursë në SMU
- Vërtetimi për statusin e studentit (lëshohet nga Fakulteti)
- Pasqyra e notave (lëshohet nga Fakulteti)

I. *Shuma e mjeteve që do të ndahet për bursa universitare caktohet me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues.*

Studentët bursistë do ta gëzojnë këtë të drejtë për vitin akademik 2020/2021.

Afati i aplikimit zgjat prej datës 27.10.2020 deri më 11.11.2020.

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në fakultetet përkatëse.

Shkarkoni Fletëparaqitjen nga raporti i aplikimit në SMU.